



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**VENDIM**

**Nr. 146 Datë 26.10.2012**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E PËRDITËSIMIT  
TË APLIKIMIT TË TARIFAVE TË CEZ SHPËRNDARJE SH.A PËR  
PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, Vendimit nr. 80, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a për rishikimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga CEZ Shpërndarje sh.a, për konsumatorët tariforë, për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014 në zbatim të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për Përditesimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për CEZ Shpërndarje sh.a për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014 në zbatim të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike”.
2. Fillimin e procedurave për Përditesimin e tarifës të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga CEZ Shpërndarje sh.a. për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014 në zbatim të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shitjes me pakicë për klientet tariforë”.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e ÇEZ Shpërndarje sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**